



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 6 i Regj. Themeltar  
Nr. 6 i Vendimi**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

**Ilir PANDA  
Sokol Sadushi  
Ervin Pupe**

**Kryesues  
Anëtar  
Anëtar**

në datën 30.07.2021, mori në shqyrtim, në dhomën e këshillimit, çështjen penale me nr. 6-2021 akti, që i përket palëve:

**KËRKUES:**

Eduart Shima.

**OBJEKT:**

Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1, datë 08.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 432 e vijues i Kodit të Procedurës Penale.

**KOLEGJI PENAL**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Nga dosja gjyqësore rezulton se, kërkuesi Eduart Shima, nëpërmjet avokatit mbrojtës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë, së bashku me rekursin kërkesën me objekt: “Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 01, datë 08.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

2. Rezulton se Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka paraqitur për gjykim procedimin penal, në ngarkim të të pandehurve; Haxhi Ramadani, Gazmend Garupi,

Sotiraq Andoni, Bledjan Ramadani, Eduart Shima, Pëllumb Pali, Shpëtim Kiri, Nikolla Mano, për kryerjen e veprave penale; “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” më shumë se një herë, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave” në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298/3, 189, 333/a/2 dhe 334/1 i Kodit Penal.

**3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 12, datë 07.07.2020**, ndër të tjera, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Shima, për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve” më shumë se një herë, në kuadër të grupit të strukturuar, parashikuar nga nenet 298/3 dhe dënimin e tij në lidhje dhe me nenin 334/1 me 10 (dhjetë) vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Shima, për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a/ të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim. Në bashkim dënimesh, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Eduart Shima me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të KPP, dënimin përfundimisht të të pandehurit Eduart Shima me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Eduart Shima fillon nga dita e arrestimit dhe do të kryhet në burgjet e sigurisë së zakonshme”.*

**4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 01, datë 08.01.2021**, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 07.07.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Shpenzimet procedurale edhe në këtë shkallë të gjykimit i ngarkohen solidarisht të pandehurve”.*

5. Kundër vendimit nr. 01, datë 08.01.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs i gjykuari Eduart Shima, duke kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 01, datë 08.01.2021, duke parashtruar këto shkaqe:

- Bazuar në faktin që Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka dhënë vendimin pa u lexuar dosja edhe provat, pa u relatuar dosja edhe ankimi nga anëtarët e trupit gjykues, fakt i vërtetuar nga procesverbali i seancës së datës 08.01.2021, e bën gjykimin në Gjykatën e Apelit absolutisht të pavlefshëm edhe një akt të papërdorshëm për këtë arsye duhet që të pezullohet vendimi i rekursuar.

- Një arsye që mbështet pezullimin e ekzekutimit të dënimit, është fakti se rekursuesi është me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, masë e cila vazhdon të jetë në fuqi edhe të respektohet prej rekursuesit Eduart Shima.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), evidenton se kërkuesi ka paraqitur në Gjykatë të Lartë rekurs ndaj vendimit me nr. 01, datë 08.01.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku pjesë të këtij rekursi ka edhe kërkesën me objekt: *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 01, datë 08.01.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.* Në këtë rekurs evidentohen pretendime në lidhje me bazueshmërinë e vendimit me nr. 01, datë 08.01.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa në lidhje me kërkimin për pezullimin e ekzekutimit të vendimit kërkuesi parashtron se, pezullimi i ekzekutimit të vendimit duhet të

vendoset pasi, gjykimi në Gjykatën e Apelit është i pavlefshëm si dhe për faktin se i pandehuri është me masë sigurimi “arrest në shtëpi.

7. Kolegji vlerëson se shkaqet e parashtruara nga kërkuesi Eduart Shima nuk përfshihen në rrethanat e parashikuara në nenin 476/1 të KPP. Neni 476/1 parashikon se: *Gjykata që ka dhënë vendimin e dënimit, me kërkesën e të dënuarit, të mbrojtësit ose të prokurorit, mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në këto raste: a) kur i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin e vendimit. Ekzekutimi shtyhet gjer në shërimin e të dënuarit; 269 b) kur e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç. Ekzekutimi shtyhet gjer sa fëmija të bëhet një vjeç; c) kur vuajtja e menjëhershme e dënimit mund të sjellë pasoja të rënda për të dënuarin ose familjen e tij. Shtyrja e ekzekutimit në këto raste nuk mund të zgjatet më tepër se gjashtë muaj; ç) në çdo rast tjetër që çmohet nga gjykata si i veçantë, duke u shtyrë ekzekutimi gjer në tre muaj.*

8. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur në Gjykatën e Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 01, datë 08.01.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara dhe për rrjedhojë nuk duhet të pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 433 dhe 476 të Kodit të Procedurës Penale,

### **V E N D O S I:**

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Eduart Shima, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 01, datë 08.01.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

**Tiranë, më 30.07.2021**

**A N Ë T A R**

**Ervin PUPE**

**A N Ë T A R**

**Sokol SADUSHI**

**K R Y E S U E S**

**Ilir PANDA**